



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.548/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12,1.17, të Ligjit 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 18, neni 32 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 5 dhe 14 të Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur më datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Rrahman Beqiri, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, për zgjedhet dhe caktohet gjyqtar në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- II. Z. Beqiri, do të filloj punën në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, më datë 1 shkurt 2024.
- III. Z. Beqiri, të vazhdoj trajtimin e lëndëve të cilat ndodhen në shqyrtim gjyqësor e në të cilat është kryetar kolegji edhe pas datës 1 shkurt 2024, nëse ato nuk përfundojnë ndërsa nënkryetari i gjykatës të njoftoj KGJK-në me listën e lëndëve ku mbetet i angazhuar gjyqtari.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.239/2023, të datës 12 qershor 2023, ka shpallur konkurs të brendshëm për tre (3) pozita të lira për gjyqtarë, në kuadër të Departamentit Special të Gjykatës Themelore Prishtinë.

Komisioni për Përzgjedhjen e Gjyqtarëve të Departamentit Special, pas përfundimit të procesit të intervistimit dhe vlerësimit të të gjithë kandidatëve, konform Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, listën e kandidatëve për gjyqtarë në Departament Special të Gjykatës Themelore Prishtinë, në mesin e të cilëve edhe z. Rrahman Beqiri.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas shqyrtimit të rekomandimeve të Komisionit, si dhe pas votimit të fshehtë për kandidatët e rekomanduar, në takimin e mbajtur më 27 dhjetor 2023, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Rrahman Beqiri;
- Nënkryetari të Gjykatës Themelore Mitrovicë
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.